

Ora e Kodit PESH (Pyetjet e Shpeshta)

Akoma keni pyetje?
Ne kemi pergjigje.

ORA
E
KODIT

A do të zgjas Ora e Kodit një orë?

Shumë nxënës do të jenë në gjendje të perfundojnë aktivitetet e tyre në më pak se një ore, dhe kjo është në rregull! Nxënësit mund të vazhdojnë të mësojnë përderisa nxënësit e tjerë i kryejnë aktivitetet e tyre.

A duhet që të gjithë nxënësit të bëjnë aktivitetin e njejtë?

Nxënësit mund të punojnë në aktivitete të cilat i përshtaten nivelit të tyre të përvojës dhe interesave - jo cdo nxënës ka nevojë të bëjë aktivitetin e njejtë në të njejtën kohë.

A mund të zhvilloj një Orë Kodimi jashtë Javës së Edukimit në Shkenca Kompjuterike?

Ti mund të fillosh një Orë Kodimi kurdo që ke dëshirë. Nuk ke nevojë as ta bësh në Dhjetor! Ora e Kodit është një eksperiencë e mirë mësimi për cdo kohë të vitit. Poashtu nuk kë nevojë ta regjistros eventin tënd, krejt cka duhet të bësh është të fillosh.

Pse shkencat kompjuterike?

Cdo nxënës duhet të këtë mundësinë të mësojë shkencat kompjuterike. Kjo ndihmon dukshëm në zhvillimin e aftësive për zgjidhjen e problemeve, logjikës dhe kreativitetin. Duke filluar herët, nxënësit do të kenë një bazament për sukses në cdo karrierë të shekullit 21.

Nuk di asgjë në lidhje me kodimin, a mund të mbaj event?

Natyrisht. Aktivitetet e Orës së Kodit janë të vërtë udhëhequra. Krejt cka duhet të bësh është t'i provosh udhëzuesit tonë të tanishëm, të zgjedhësh udhëzuesin që deshiron, dhe të zgjedhësh një orë - ne kujdesemi për gjërat e tjera. Ne poashtu kemi opsione të ndryshme për cdo moshe dhe nivel eksperience, që nga parashkollori e tutje. Fillo me planifikimin e eventit duke lexuar guidën tonë të planifikimit të eventit.

Cfarë pajisje duhet të përdori për nxënësit e mi?

Aktivitetet e code.org funksionojnë në të gjitha pajisjet dhe shfletuesit e internetit. Nevojat teknologjike për aktivitete jashtë code.org mund të gjinden në code.org/learn në përshkrimin e aktivitetit specifik. Mos harroni se ne poashtu ofrojmë aktivitete të shlyqura nëse shkolla juaj nuk mund t'i plotesoje nevojat teknologjike!

A kanë nevojë nxënësit të regjistrohen përmes krijimit të një llogarie?

Jo. Nuk ka nevojë për asnjë regjistrim në mënyrë që nxënësit të provojnë Orën e Kodit. Regjistrimi në Orën e Kodit nuk krijon automatikisht një llogari në code.org

Sa shumë mund të mesoj një nxënës brenda nje ore?

Qellimi i Orës së Kodit nuk është që të bëj nxënësit ekspert të shkencave kompjuterike brenda një ore. Nje orë mjafton vetëm për të kuptuar që shkencat kompjuterike janë zbavitese dhe kreative, që është e qasshme për të gjitha moshat, për të gjithë nxënësit, pa marrur parasysh prapavinë e tyre. Miliona nxënës dhe mësues kanë vendosur të mësojnë me shume se një ore - duke mësuar të gjithë ditën ose javën ose edhe me gjate, dhe shume nxënës kanë vendosur që të regjistrohen në kurse ose edhe të studiojnë shkencat kompjuterike në universitet si rezultat i këtij eventit.

**Mbi të gjitha, ajo që të gjithë pjesëmarrësit mund të mësojnë
në një orë është se ne mund ta bëjmë këtë.**